



# BULETIN INFORMATIV

Aktivitet i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në bashkinë Roskovec

Aktivitetet e muajit Korrik 2022



## AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Aktivitet i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në bashkinë Roskovec
- ◆ Takime vlerësuese në komisaritetet e DVP Tiranë
- ◆ Takime të EMP-së në DPPSh
- ◆ Takim me koordinatorin e Oficerëve të Sigurisë në MAS
- ◆ Takime me komunitetin mbi dhunën në familje në Pukë
- ◆ Takime me specialistët IT-së për projektin e qarkullimit rrugor

Gjatë muajit korrik 2022, në Bashkinë e Roskovecit u zhvillua takim radhës në kuadër të funksionimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP). Në këtë takim ishin të pranishëm kryetarja e bashkisë Majlinda Bufi, Zëvendësministrja e Brendshme, Romina Kuko dhe anëtarët e rregullt të KVSP-së.

Në fjalën e rastit, Zëvendësministrja e Brendshme, Romina Kuko përshëndeti ekipin e ekspertëve që punuan për projektin. Ajo theksoi se tashmë është bërë i mundur funksionimi formal i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, ku tanimë kemi një model të konsoliduar. Kuko theksoi se me mbështetjen e projektit suedez të Policimit në Komunitet kjo bashki ka një mekanizëm të mirë parandalues për më shumë siguri në komunitet.

Më tej, Znj. Kuko informoi se në takimin e dytë së bashku me Prezencën e OSBE-së u paraqit

Raporti i Vlerësimit të Kapitalit Natyror ku Roskoveci është ndër 3 bashkitë që po e piloton këtë model i cili ka një vlerë specifike në vlerësimin dhe shfrytëzimin me eficient të çdo burimi e pasurie të territorit të bashkisë me synimin e rritjes së mëtejshme ekonomike



**Takime vlerësuese në komisariatet e DVP Tiranë**



Në kuadër të ciklit të takimeve informuese dhe vlerësuese për impaktin e ndryshimeve të kryera në DVP Tiranë, gjatë muajit korrik 2022, ekipi i SCPA organizoi disa takime në disa prej komisariateve të DVP Tiranë .

Në këto takime morën pjesë niveli drejtues i komisariateve të mësipërme, shefat e policimit në komunitet, shefat e rendit si dhe personeli i sallës së komandimit dhe koordinimit

Ekipi i SCPA përbehej nga Këshilltari Ndërkombëtar Policor pranë SCPA dhe Koordinator i Programit .

Takimi synonte të vlerësonte impaktin e ndryshimeve të ndërmarrë gjatë gjashtë muajve të fundit në komisariatet e DVP Tiranë në detyrat e NSPK-ve dhe OPP-ve dhe të analizonte zbatimin e tyre, rezultatet për secilën prej këtyre strukturave, pritshmëritë e strukturave drejtuese dhe të vetë

punonjësve në terren, si dhe impaktin e mundshëm në raport me komunitetin dhe shtimin potencial të prezencës së NSPK-ve në zonën policore.

Sipas pjesëmarrësve në takim, tashmë OPP-të janë bërë të vetëdijshëm se tani e tutje duhet të merren ata me të gjithë procesin e punës gjatë një ndërhyrje në vendngjarje.

Gjate takimit u rekomandua ndërmarrja e hapave të qartë lidhur me informimin e të gjitha strukturave vendore të Komisarariatit dhe DVP-së dhe sidomos lidhur me ndryshimet.

Ekipi gjithashtu sugjeroi që salla e Drejtimit dhe Kontrollit të përditësohet dhe të informohet mbi ndryshimet, në mënyrë që gjatë shpërndarjes së informacionit mbi ngjarjet dhe dërgimin në vendngjarje ata të veprojnë në përputhje me përshkrimet e reja të punës për NSPK-të dhe OPP-të.

**Takime të EMP-së në DPPSh**



Në vijim të punës për zbatimin dhe vlerësimin e ndryshimeve në 12 DVP –të, EMP ka organizuar një numër takimesh në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në këtë kuadër janë takuar, drejtori i Rendit Publik Z. Zef Laska , Shefi i sektorit të Policimit në Komunitet Z. Sadri Ramcaj, si dhe anëtarët e grupit të punës për projektin e ndryshimeve në nivel qendror në DPPSh.

Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë informimi dhe përditësimi i nivelit drejtues me progresin e arritur deri tani në këto DVP si dhe koordinimi i punës në kuadër të ndjekjes periodike të zbatimit të ndryshimeve dhe vlerësimit të impaktit të këtyre ndryshimeve sipas planit të punës të projektuar nga Grupi i Punës të projektit për menaxhimin e ndryshimeve në këto DVP



### Takime me komunitetin mbi dhunën në familje në Pukë



Më datë 4 korrik 2022, “Gruaja Verilindore e Papunë” në bashkëpunim me sektorin e policimit në komunitet të komisariatit të policisë Pukë, zhvilluan aktivitetin e radhës mbi parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje, me banorë dhe përfaqësues komunitetesh në Pukë. Në takim morën pjesë përfaqësues të policimit në komunitet nga komisariati i policisë Pukë, përfaqësues nga prokuroria e rrethit Pukë si dhe përfaqësues komunitetesh, përfshirë familje në nevojë dhe organizata rinore. Pjesëmarrësit u informuan mbi raportimin e veprës penale të dhunës në familje, urdhrat e mbrojtjes, ndihmën ekonomike për viktimat e kësaj dhune. Gjithashtu ata u njohën me instrumentet parandaluese të krimit dhe kërkesës

e nevojave të vetë komuniteteve për bashkëpunim me Policinë e Shtetit për një komunitet më të sigurtë.

Përfaqësuesit e organeve ligj zbatuese shprehën mbështetjen e tyre për bashkëpunim, me synim përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm mes Policisë së Shtetit dhe komunitetit vendor si dhe rritjen e besimit të ndërsjellët Polici- Komunitet.

Pjesëmarrësit ndanë eksperiencat e tyre dhe sugjeruan një përfshirje më të madhe të institucioneve me synim parandalimin e rasteve të dhunës në familje. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të zbatimit të projektit “Në partneritet me Policinë e Shtetit për komunitet më të sigurt”, mbështetur nga raundi i 6-të i skemës së granteve.


### Takime me specialistët IT-së për projektin e qarkullimit rrugor

Në vazhdim të punës së nisur për ndërtimin e softuerit për policinë rrugore, gjatë muajit korrik, EMP ka realizuar një numër takimesh me specialistë nga sektori i IT-së në DPPSH si dhe me ekspertë programues në fushën e IT-së.

Qëllimi i takimeve ishte përditësimi me punën që po kryhet për përfundimin e këtij softueri.

Ky softuer do të përdoret nga policia rrugore në radarët për të kontrolluar në sistemin e Policisë

në kohë reale makinat, drejtuesit e mjeteve, gjobat, autorët e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor pasi janë të lidhur në kohë reale me sistemet e PSh-së.



### Takim me koordinatorin e Oficerëve të Sigurisë në MAS

Gjatë muajit Korrik 2022, EMP ndërmori disa iniciativa për ri-aktivizimin e oficerëve të sigurisë ( OS) në shkollat e mesme.

Me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve “ Për zbatimin e programit Siguria e të Rinjve”, krijohen premisat për të rritur bashkëpunimin me palët dhe institucionet e tyre të varësisë dhe marrjen e përgjegjësisë për të qenë pjesë e këtij programi.

Në këtë kuadër, EMP ka biseduar me koordinatorin e Oficerëve të Sigurisë në MAS, si dhe ka komunikuar elektronikisht, për mundësinë e ri aktivizimit të OS-ve në punën me temat e ndërgjegjësimit për të cilët janë dhe trajnuar nga programi SCPA sipas një grafiku të miratuar bashkërisht

SCPA si palë në mbështetje të PSH, mendon se është koha e duhur që në shtator, 2022, kur dhe fillon sezoni i ri shkollor ,që Oficeret e Sigurisë (OS) në shkolla të fillojnë gradualisht aktivitetet ndërgjegjësuese

SCPA shpreh gatishmërinë që të ofrojë praktiken e mirë të aplikuar me oficeret e policimit në Komunitet për edukimin dhe punën me të rinjtë dhe të sigurojë materialet didaktike në formë elektronike dhe fletë palosje sipas moduleve të ndërgjegjësimit.